



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson-Institution

Mj.Bri/No. 1628/2021
Nr.i foli/str./Nr.pg.
Datë/Datum/Date: 18/10/21



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËAN E PARABURGIMIT NË MITROVICË

Për: Znj. Albulena Haxhiu, ministre
Ministria e Drejtësisë

Znj. Dafina Gexha Bunjaku, U.D ministre
Ministria e Shëndetësisë

Kopje: Znj. Duda Balje, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe
Peticione

Z. Habit Hajredinaj, drejtor
Zyra e Kryeministrat - Zyra për Qeverisje të Mirë

Z. Ali Gashi, ushtrues detyre i drejtorit të përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, drejtor
Departamenti për Shëndetësinë në Burgje

Z. Benasim Mediç (origj: Benasim Medič), drejtor
Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë

Prishtinë, më 18 tetor 2021

HYRJE

Mekanizmi Kombëtar për Pandalim të Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 29 korrik 2021, vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM).

Qëllimi i kësaj vizite ishte shqyrtimi i respektimit të të drejtave të njeriut për të burgosurit e vendosur në QPM, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në QPM pranohen të paraburgosurit dhe të dënuarit me dënimë nën 20 vjet. Të burgosurit janë të nacionaliteteve të ndryshme dhe janë të vendosur në dy kate.¹ Sipas drejtorit të QPM-së, kapacitetit i kësaj qendre është për 77 persona. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi QPM-së, ishin të akomoduar 52 persona.

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

1. Gjatë vizitës që MKPT-ja i bëri QPM-së, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e burgut, iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën. Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, ekipi përdori fotoaparatin pa u penguar fare nga autoritetet e QPM-së.

Keqtrajtimi fizik

2. Gjatë vizitës në QPM, MKPT-ja mori ankesa për keqtrajtim fizik dhe përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja vërejti se komunikimi interaktiv ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve në përgjithësi është në nivel të kënaqshëm, por po ashtu në raste të caktuara u vërejtën tensione në marrëdhëni ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të burgosurve. **Po ashtu, në rast të caktuara, MKPT-ja mori pohime për keqtrajtim fizik dhe përdorim të tepruar të forcës fizike.**
3. Sa u përket pretendimeve të caktuara për keqtrajtim fizik dhe përdorim të tepruar të forcës fizike, MKPT-ja konsideron se menaxhmenti i QPM-së duhet të jetë vazhdimesht vigilant dhe që personelit korrektues t'i dërgojë mesazh të qartë se çdo formë e keqtrajtimit, përfshirë abuzimin verbal, është e kundërligjshme dhe do të ndëshkohet në pajtim me ligjet në fuqi.
4. Po ashtu, personeli korrektues, në mënyrë të prerë duhet të përdorë vetëm forcën e domosdoshme dhe proporcionale për të futur të burgosurin nën kontroll dhe në momentin

¹ Të dhëna nga ueb-faqja zyrtare e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në: <https://shkk.rks-gov.net/institution-single/2236>.

që i burgosuri futet nën kontroll, nuk mund të justifikohet përdorimi i mëtejmë i forcës fizike.

5. Gjatë vizitës, një numër i madh i të paraburgosurve të përkatësisë etnike serbe ka refuzuar takimin me përfaqësuesit e MKPT-së, disa prej tyre nuk kishin interesim dhe në disa raste, për shkak të përkatësisë etnike të anëtarëve të MKPT-së, nuk kishin besim ndaj MKPT-së.
6. MKPT-ja shpreh keqardhjen për këtë qëndrim dhe mosbesim ndaj MKPT-së. Sikurse në të kaluarën, MKPT-ja do të vazhdojë të kryejë punën e vet sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, duke pasur qasje profesionale dhe pa diskriminim ndaj të gjithë personave të privuar nga liria e tyre, pavarësisht përkatësisë etnike, gjinore, racore dhe sipas të gjitha bazave të tjera kundër diskriminimit, të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës dhe në standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të njeriut.

Kushtet e akomodimit

7. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë në strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjenike dhe rrëthanave vendore klimatike.² Më tej, ligji përcakton: “*Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme, ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta. si dhe sasi të mjaftueshme të drithës natyrore dhe artificiale për punë, lexim, ngrohje dhe ajrosje.*”³ Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi, duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.⁴
8. Në përgjithësi, kushtet e akomodimit në QPM mund të konsiderohen të pranueshme, përveç në raste të caktuara, **në kuptim të hapësirës për banim për një të burgosur, ku kushtet e akomodimit nuk janë në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT).**
9. Nga matjet e realizuara nëpër qeli del se disa qeli janë larg standardit të përcaktuar me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të të burgosurve.
10. Po ashtu, MKPT-ja mori ankesa nga të burgosurit për shkak të temperaturave të larta në qelitë e tyre. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime për të evituar këtë mangësi, e cila është më e theksuar gjatë stinës së verës. Lidhur me këto mangësi, MKPT-ja u njoftu nga drejtoria se planifikohet ndërtimi i një qendre të re të paraburgimit, por deri më tani nuk ka ndonjë vendim zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

² Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

³ Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 3, paragrafi 2.

⁴ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 3.

Ushqimi

11. LESP-ja përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojlojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'i përshtatet kërkësave të tij fetare dhe kulturore. Më tej ligji përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.⁵ Po ashtu, LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurit që gjatë gjithë kohës të ketë në dispozicion ujë të pijshëm.⁶
12. Rregullat e Mandelës, që është një akt i rëndësishëm juridik ndërkombetar për të drejtat e të burgosurve, përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim adekuat për shëndetin e tyre, si dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë kohës.⁷ Në këtë drejtim, Rregullat Evropiane të Burgjeve po ashtu përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim dietal, duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre fizike, religjionin dhe natyrën e punës së tyre. Ndërsa ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në kushte adekuate higjenike, kurse uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës.⁸ **MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit lidhur me këto të drejta.**

Regjimi

13. Sa i përket regjimit, në QPM rreth 16 të dënuar janë të angazhuar në punë. Në kuadër të QPM-së funksionojnë pesë punëtori, në të cilat të dënuarit mund të angazhohen në punë dhe në trajnime të ndryshme. Të dënuarit kanë të drejtë në së paku 2 orë shëtitje në ditë.⁹ Në dispozicion të të burgosurve janë edhe biblioteka, shëtitoret dhe salla e fitnesit. Të paraburgosurit nuk angazhohen në punë pasi angazhimi në punë dhe në aktivitetet e tjera është subjekt i lejes nga gjykata kompetente. **MKPT-ja mori ankesa nga të paraburgosurit, të cilët, sipas pohimeve të tyre dhe të drejtorit, kalojnë shumicën e kohës në qelitë e tyre (rreth 22 orë).**
14. Lidhur me regjimin për të paraburgosurit, MKPT-ja e Avokatit të Popullit, edhe në të kaluarën ka shprehur shqetësimin për shkak të regjimit tepër të varfér dhe ka rekomanduar që të bëhen përpjekje për të rritur angazhimin e të paraburgosurve në punë dhe në aktivitete të tjera të mirëfillta, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.
15. **Në këtë drejtim, MKPT-ja konsideron se sa më e gjatë që të jetë kohëzgjatja e paraburgimit, aq më i pasur duhet të jetë regjimi që u ofrohet të paraburgosurve.¹⁰**
16. Gjatë vizitës, MKPT-ja mori ankesa nga të burgosurit e përkatësisë etnike serbe, të cilët u ankuau se për ta nuk ekziston një burg apo njësi e burgut e tipit të hapur, siç është Qendra Korrektyuese në Smrekonice, në të cilën nuk akomodohen të burgosurit serbë. Në këtë

⁵ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, paragrafët 1 dhe 2.

⁶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 40.

⁷ Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

⁸ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat 22.1 deri 22.6.

⁹ Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje.

¹⁰ MKPT, Letër rekomandimi për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, publikuar më 16 dhjetor 2019. Shih në: <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/12/Leter-rekomandim-perkitazi-me-viziten-ne-QP-Peje.pdf>.

drejtim, MKPT-ja konsideron se të gjithë të burgosurit duhet të trajtohen pa dallim, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet në fuqi.

Kujdesi shëndetësor

17. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilat nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrekta, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjeter për përkujdesje shëndetësore.¹¹
18. Personeli mjekësor i QPM-së përbëhet prej një mjeku me kontratë të rregullt, i cili punon nga ora 07:00 -15:00, çdo të dytën ditë, dhe në thirrje 24 orë. Po ashtu në dispozicion të Njësisë Shëndetësore janë 6 infermierë të rregullt, ku 5 infermierë punojnë me ndërrime nga 24 orë, ndërsa kryeinfermierja nga ora 08:00 deri në 16:00. Po ashtu janë një psikolog dhe një stomatolog të kontraktuar, të cilët punojnë në ditë të caktuara dhe sipas nevojës.
19. Sa i përket infrastrukturës, Njësia Shëndetësore posedon dhomën ku kryhen vizitat mjekësore, intervenimet, trajtimet stomatologjike, dhoma e psikologut dhe dhoma e kryeinfermierit. MKPT-ja konsideron se kjo hapësirë nuk është adekuat për ofrim të shërbimeve mjekësore dhe nuk mbron konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore. Njësia Shëndetësore posedon EKG-në, ultrazërin, bombolën e oksigenit, defribilatorin, tensimetrin, materialin shpenzues dhe shok-terapinë.
20. Shërbimet e tjera mjekësore ofrohen nga qendra më e afërt e mjekësisë familjare dhe nga spitali rajonal. Përveç kësaj, Njësia Shëndetësore i posedon të gjitha protokollet relevante mjekësore. **MKPT-ja ka pranuar ankesa nga të burgosurit e përkatësisë etnike shqiptare se personeli mjekësor në këtë njësi shëndetësore nuk e flet gjuhën shqipe dhe në këtë mënyrë komunikimi me personelin mjekësor është i vështirë dhe joadekuat.**

Rëndësia e kontrolleve mjekësore të të burgosurve të sapopranuar

21. KPT-ja dhe aktet e tjera juridike ndërkombëtare vazhdimisht theksojnë rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të sapopranuar, veçanërisht në institucionet që përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
22. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të jatin kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.¹²

¹¹ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 43, paragrafi 2.

¹² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

23. LESP-ja¹³ dhe Praktika Standarde e Veprimeve (PSV)¹⁴ e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapopranuar t'i nënshتروhet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit.
24. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombe të përmbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁵, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁶ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹⁷
25. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e sapopranuar kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh, nga momenti i arritjes në QPM.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

26. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me PSV-në¹⁸, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me LESP-në¹⁹, me standartet e KPT-së,²⁰ si dhe me aktet ndërkombe të përmbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²¹
27. Për më shumë, edhe standartet e KPT-së po ashtu përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen ashtu që të mos shihen dhe të mos dëgjohen nga zyrtarët korrektues, përveç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.
28. Po ashtu, nen 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, shprehimisht përcakton: “*Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.*”
29. Bazuar në informatat nga stafi i shërbimit shëndetësor dhe në intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore, në përgjithësi, jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur nga mjeku kërkohet prania e zyrtarëve korrektues.

Masat disiplinore

30. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vëtmia.²³ Kurse në rastin e të paraburgosurve mund t'u shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondecës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e

¹³ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 31.

¹⁴ Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹⁵ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

¹⁶ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

¹⁷ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

¹⁸ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹⁹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 49.

²⁰ Standartet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafet 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

²¹ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

²² Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

²³ Paragrafet nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Popullit dhe me misionet diplomatike, Gjatë vizitës në QPM nuk pati të burgosur të ndëshkuar me masën disiplinore të vëtmisë.

31. MKPT-ja u njoftua se shërbimi mjekësor nuk merr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të të dënuarit, për ta përballuar masën disiplinore të vëtmisë. MKPT-ja konsideron se personeli mjekësor e ka të qartë rolin e tij në këtë aspekt. Pjesëmarrja e mjekut në vendimmarrje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo të dënuar, do ta minonte raportin mjek-pacient, përveç nëse kjo masë ndërmerr përsye mjekësore.²⁴
32. Gjatë vizitës, MKPT-ja vërejti se të ndëshkuarve me masë disiplinore të vëtmisë iu dorëzua kopja e vendimit, i cili përmban edhe këshillën juridike për mjetin juridik që mund të përdoret kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore.

Kontakti me botën e jashtme

33. Legjislacioni në fuqi²⁵, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korresponcencë (që u nënshtrohen përashtimeve të caktuara), kanë të drejtë në pranimin e vizitave së paku një herë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe përvizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre; së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike.
34. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese²⁶ përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhë me personat e tjera. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
35. Të dënuarit në regjim themelor mund t'i lejohet një thirrje telefonike gjatë javës, e cila zgjat 15 (pesëmbëdhjetë minuta), ndërsa të dënuarve në regjim të avancuar mund t'u lejohen dy thirrje telefonike, të cilat zgjasin 15 (pesëmbëdhjetë minuta). Megjithatë, **MKPT-ja mori ankesa nga të burgosurit e përkatësisë etnike shqiptare se atyre u kufizohen telefonatat në 10 minuta. Drejtori i QPM-së i ka hedhur poshtë këto pohime.**
36. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*”, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat e tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit, del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj, sipas lejes së gjykatës dhe një vizitë shtesë nga drejtoria, bazuar në kërkesën e parashtruar nga i paraburgosuri, në rrethana të caktuara.
37. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të

²⁴ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpritet praktika që nga mjeku të kërkohet vërtetim se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje për ta përballuar masën.

²⁵ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

²⁶ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjyques apo të kryetarit të trupit gjyques ose të personave të tjera të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.

38. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.²⁷

Hapësirat ku pranohen vizitat

39. Gjatë vizitës, MKPT-ja vizitoi edhe hapësirat në QPM ku pranohen vizitat familjare. Kushtet në këto hapësira mbeten në nivel të kënaqshëm. Po ashtu, dhoma ku kryhen vizitat e lira është në gjendje të mirë, përfshirë edhe tualetet dhe pajisjet e tjera relevante.

Incidentet ndërmjet të burgosurve

40. Sipas Drejtorisë, nga fillimi i vitit 2021 dhe deri më tanë kanë ndodhur 25 incidente. MKPT-ja vërejti se këto incidente, pas kontrolleve adekuate mjekësore dhe hetimeve të zhvilluara, janë evidentuar në formularë përkatës administrativë dhe mjekësorë.

Procedura e parashtrimit të ankesave

41. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut, apo brenda qendrës së paraburgimit ku vendosen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

42. Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.²⁸

43. MKPT-ja vërejti se në dispozicion të të burgosurve në QPM janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga DShB-ja dhë kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP). Kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa sa i përket respektimit të kësaj të drejte.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të MKPT-së gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

²⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 33, paragrafi 1.

²⁸ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim."

REKOMANDON


Ministrisë së Drejtësisë:

1. Përderisa është në përdorim QPM-ja, të burgosurve duhet t'u garantohen kushtet e akomodimit në pajtim me LESP-në, me standartet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve, si dhe me standartet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës. (Shih paragrafen 7 deri 10 të tekstit)
2. Menaxhmenti i QPM-së t'i dërgojë personelit korrektues mesazh të qartë se çdo formë e keqtrajtimit, përfshirë abuzimin verbal, është e kundërligjshme dhe do të ndëshkohet në pajtim me ligjet në fuqi.
3. Kohëzgjatja e telefonatave të jetë në pajtim me Rendin Shtëpiak në fuqi.
4. Të paraburgosurve, sa herë që një gjë e tillë është e mundur dhe plotësohen kriteret ligjore, t'u ofrohet punë dhe aktivitete të tjera të mirëfillta.

Ministrisë së Shëndetësisë:

1. Duke pasur parasysh numrin e të burgosurve shqiptarë në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, të bëhen aranzhime në mënyrë që të burgosurit të pranojnë shërbime mjekësore në gjuhën të cilën ata e kuptojnë.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit